



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 530 Prot.

Tiranë, më datë 18.02.2020

VENDIM

Nr. 51, datë 19.02.2020

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 48 dhe neni 134 dhe V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, pas shqyrtimit më parë në Këshillin Teknik të Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore të relacionit të verifikimit në terren për gjetjet në kuadër të zbatimit të projektit “Rikonstruksioni i rrugëve të brendshme të kalasë së Ali Pashë Tepelenës dhe vazhdimi i shëtitores përgjatë hyrjes së kalasë loti II (segmenti porta perëndimore – busti i Selam Musait) realizuar nga DSHA, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 19.02.2020,

VENDOSI:

1. Subjekti Bashkia Tepelenë duhet të kontraktojë një subjekt të licencuar në arkeologji për kryerjen e gërmimit arkeologjik të shpëtimit të kullës rrethore, duke lidhur më parë akt-marrëveshje tre palëshe, me IKTK i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt.
2. Raporti i rezultateve të gërmimit arkeologjik të shpëtimit të paraqitet për shqyrtim dhe vendimarrje në mbledhjen e radhës së KKTKM.
3. Pas përfundimit të gërmimit arkeologjik të shpëtimit të kryhet konservimi/ restaurimi i kullës me qëllim ekspozimin e saj.
4. Për pjesën tjetër të punimeve të zbatimit të subjekti investitori duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit për këtë projekt si dhe Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë subjektin;
5. Subjekti aplikues duhet të vijojë me procedurën ligjore për miratimin sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
6. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, nenet 144-147;
7. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

8. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Arta DOLLANI

KRYETAR
Elva MARGARITI

